



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:057456

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05814735

2023:065705

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me zyrtarin ligjore te kësaj gjykate Ymri Ibrahim, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.S., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.287/23 të datës 14.03.2023, në praninë e prokurores së shtetit Mimoza Syla Hyseni, të akuzuarit E.S., i dëmtuari A.H., pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më dt. 15.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 12.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: E.S., i lindur me 20..., nga i ati F. dhe e ëma N., e gjinisë I. me vendbanim fshati D.. Komuna Ferizaj, i martuar, me profesion ekonomist, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptarë, shtetas e Republikës së Kosovës, me numër personal 1..

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

me datë 20.02.2023 rreth orës 10:00 në Ferizaj, saktësisht në kontrollën teknike “R.” në rrugën ..., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, duke fshehur faktet në mënyre mashtruese ka vënë në lajthim të dëmtuarin A.H., në atë mënyrë që ka bërë manipulimin e kilometrave në automjetin e markës “Audi A4 ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 2012 me numër të shasisë W...,me targa 05... duke ndryshuar kilometrat e

veturës nga 328839 mijë km sa kishte fillimisht kur i është bërë kontrolli teknik veturës në E...SHPK në Fushë Kosovë ,me datën 06.08.2020, në 150295 mijë km të ndryshuara, të vërtetuara në kontrollin teknik të veturës të bërë në QKTA- “R..” në Ferizaj me dt.02.11.2021, ashtu që është vërtetuar se veturës në fjalë i janë zvogëluar kilometrat, dhe të njëjtin automjet ia ka shitur të dëmtuarit A.H.

-me të cilën ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39,43, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe neni 364 të KPPK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 /katër/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 /një/ viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Dhe me dënim me gjobë në shumën prej 300 € (tre gjind euro), i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € /njëzetë/euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 20 € /njëzet/ euro, brenda afatit prej 30/ tridhjetë / ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.287/2023 të datës 14.03.2023 e ka ngarkuar të akuzuarin E.S., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 15.05.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i akuzuari E.S. dhe av.sipas detyrës zyrtare Elvira Heta dhe te dëmtuarit A.H. .

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 319 par. 1 dhe par.2 të KPPK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 321 par.1 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari E.S. me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në fillimi të shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë, ndërkaq në shqyrtim gjyqësorë i akuzuari ka theksuar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bënë në shenjë pendimi për veprën të kryer.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 322 par. 1 të KPPK-së ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së: i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i oficerit i dt.20.02.2023, deklarata e QAK-së E..e datës 06.08.2020,deklarata e të dëmtuarit të dhënë në polici me dt.16.02.2023 deklarata e te pandehurit të dhënë në prokurori me dt.13.03.2023 si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Fjala përfundimtare e palëve

Pasi që gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, konform nenit 350 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Mimoza Sylja në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar: konform nenit 351 paraqes fjalën përfundimtare në çështjen penale kundër të akuzuarit E.S. për veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, mbetem pranë aktakuzës me nr.287/23 e dt. 14.03.2023, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë ky pranim është konform nenit 242 të KPPRK-së dhe mbështetet në faktet që përmban aktakuza. Atëherë i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpalle fajtores dhe ti shqiptoj sanksion të paraparë me ligj. Ndërsa me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit gjykata të ketë parasysh si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor ndërsa rënduese shkallën e lartë të dashjes duke e vënë në lajthim të dëmtuarin.

I dëmtuari A.H. në fjalën përfundimtare deklaroi: I bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe paraqes kërkesë pasurore juridike. Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, nuk kam tjetër çfarë të shtoj. Avokatja Elvira Heta në fjalë përfundimtare deklaroi: pas pranimin të fajësisë nga i mbrojturi im . Pranimi i bërë në mënyrë vullnetare dhe të sinqertë duke shprehur pendim për veprimet e pamenduara , e i cili u pranua me aktvendim nga kjo gjykatë që i njëjti të merret si rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit i cili i shërben pranimin të ekonomizimit të procedurës penale . Mbrojtja kërkon nga gjykata që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të aplikoj dispozitat për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim nën minimumin e paraparë duke pasur parasysh herën e parë që bie ndesh me ligjin pranimin e fajësisë ,pendimin e thellë dhe premtimin se nuk do të përsërisë veprimet të inkriminuara me ligj.

I akuzuari E.S. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se është penduar thellë, ka kërkuar falje publike, është hera e parë që bie ndesh me ligjin , premtoj se nuk do të përsëris vepra të tilla penale si dhe e lus gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Të gjeturat e gjykatës, matja dhe shqiptimi i dënimit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se i akuzuari është i martuar, respektivisht mbajtës i familjes, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata pati parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje si dhe e vlerësoi peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarin.

Prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është marrë konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
2023:065705, me dt. 12.06.2024

Zyrtari Ligjor
Ymri Ibrahim

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.